



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 7.3.2025

Nr: 246

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË ZYRËS VENDORE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR SHKODËR, PËR PERIUdhËN 23 SHKURT-1 MARS
2025**

Sot, më datë 7.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

SUBEKT: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër,

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, për periudhën 23 shkurt- 1 mars 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 23 shkurt- 1 mars 2025, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- “Aktivitete organizuar nga ZVAP Shkodër, me pjesëmarrjen e IAP në juridiksion”, raportuar në datë 27.2.2025 për t’u zhvilluar në datë 3.3.2025.
- “Panair i punës, WorkShop”, raportuar në datë 1.3.2025 për t’u zhvilluar në datë 5.3.2025.

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Data: 7.3.2025 Nr. 246
Ora:18:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, për periudhën 23 shkurt -1 mars 2025”

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: “...Aktiviteti ka qenë i planifikuar të zhvillohej në datën 03.03.2025. Në datën 27.02.2025, është raportuar nga ana jonë në ndërfaqen e raportimeve mbi planifikimin e këtij aktiviteti, i cili u ndalua automatikisht nga NRI. Për këtë arsye, aktiviteti nuk u zhvillua dhe u raportua përsëri, për ta zhvilluar në datën 06.03.2025...

Lidhur me raportimin për aktivitetin “Panairi i Punës, Work Shop”, sqarojmë se, ky është një aktivitet që zhvillohet nga ministria e linjës Ministria e Arsimit dhe Sportit, ku Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër është pjesëmarrëse në cilësinë e të ftuarit. Në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, raportimi, në cilësinë e të ftuarit, nuk përbën detyrim nga ana e institucioneve për raportim, por për arsye transparence, e kemi parë të udhës që të deklarojmë edhe pjesëmarrjet”.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaritë publike e zhvilluar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Pasi veprimtaria kanë marrë shënimin si “e ndaluar” në NRI, aktiviteti nuk është zhvilluar. Aktiviteti është riraportuar në ndërfaqe me datën e zhvillimit duke respektuar afatet ligjore.

Referuar aktiviteti me temë “Panairi i Punës, Work Shop”, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se personi përgjegjës për raportimin i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, nuk ka patur mundësi të raportojë në kohë për këtë aktivitet për shkak se ka qenë në cilësinë e të ftuarit dhe nuk ka detyrim për raportim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI